

ELMA RAMA

GUASKA

POEZI

BOTIMET TOENA

ELMA RAMA

GUASKA

poezi

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Recensente: Natasha Lako

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike: Gea Qëndro

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928960740

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

NJË ÇELËS QË HAP ZEMRËN

Që nga koha kur Safo çeli portat e poezisë më të bukur botërore, kanë kaluar mijëra vjet.

Miliona e miliona njerëz nëpër rrugë të ndryshme komunikimi, hynë në botën e këndvështrimeve poetike që nga luftërat te dashuritë.

E të jetosh pranë kaltërsive të ujërave midis rrjedhave të detit Adriatik dhe Jon, është diçka tjetër; gati e papërballueshme, me gjerësitë dhe thellësitë ku jeton vetë gjendja e njeriut. E njeriu, ka vetëm një peshë, një trup e një zemër.

Një prej tyre është Elma Rama, nga e cila kanë lindur edhe tre zemra të tjera.

Në poezi ajo ka vendosur të qëndrojë me zemrën e saj.

Para një deti ajo kërkon një det tjetër. Para një qielli ajo kërkon një qiell tjetër. Para vetes, ajo kërkon një njeri tjetër. Ndryshe ajo nuk mund ta arrijë gjithësinë.

Poezia e Elma Ramës ka lindur si kërkim, ku vetë gjendja njerëzore që gjithnjë ndryshon, krijon një hapësirë të pafund konkurrencte me ato të qiellit dhe të deteve.

Në ditët e sotme, kur sapo kemi mësuar edhe betejat tregtare, kur kemi mësuar edhe çfarë i jep Lesoto në tregti Sh.B.A-ve, kur e dimë edhe

fatkeqësinë e një cepi të botës, si mall i një cepi tjetër, jemi më të ndërgjegjshëm se kurrë, ndoshta në sajë të shpejtësive të sotme të komunikimit edhe për gjendjen sociale gjithnjë në ndryshim e sipër për mirë apo për keq të realitetit femëror, si një glob brenda globit, ku edhe gruaja shqiptare ka krijuar portretin e vet. Dhe poezia mbetet gjithnjë një çelës i madh zbërthyes, i një bote të thellë të brendshme, ku bëhet një zëdhënëse edhe Elma Rama. Kjo është bota e gruas në kërkim të vetes. Përmbushje dhe boshllëk, në këtë poezi duket sikur plotësohen ose tërhiqen nga fjala. Të jetosh me veten, në jetën e gruas kërkohet një forcë e brendshme e madhe.

Të vesh në qendër të poezisë një vete të munguar, për të krijuar një tjetër, dihet që është mundim i madh. Në poezinë e Elma Ramës, lexuesi gjendet në kufirin midis mundimit për të ndryshuar një gjendje të jetës dhe vuajtjes, e cila vetëm sikur pret në prag, pa u shfaqur dot. Sprovat e gjendjeve të saj, krejt si pa u vënë re, kthehen në poezi, duke ruajtur dinjitetin e përjetimeve të brendshme që falin një liri të madhe. Boshllëku bëhet i mjaftueshëm, për të shfaqur ndjenja femërore. Nuk ka qenë kaq e lehtë, shprehja e mungesave të mëdha, të cilat më tepër shfaqin dramë njerëzore, për kuptimet dhe për moskuptimet, pa të cilat jeta nuk mund të ecë përpara. Koha idilike ka përfunduar. Iluzionet kanë marrë fund dhe jeta shihet drejt në sy, si e stolisur nga mungesa dhe brejtje. Një poezi e tillë lind në çaste të një qetësie të jashtme, pa të cilën nuk e dëgjon dot as trupin në përgjithësi, as zemrën. Rëndësi ka që ekziston njeriu që e do.

“Njeriu mund të ndihet njeri vetëm nga dashuria”,
thotë Elma Rama.

Nga të gjithë anët, vargjet e Elma Ramës janë të rrethuara nga dilema, për të heshtur, apo të lëmoj dy gurë që duke u përplasur të krijojnë flakën.

Ka përfunduar koha e dashurive të para, e adoleshencës të pafajshme.

Në këto poezi gjendemi para dy fajtorëve për dashurinë e tyre. Në këtë gjendje amorfe, mund të ekzistojë vdekja.

Prania e vdekjes, është një temë tjetër, që vërtitet rreth motiveve të dashurisë.

Vdekja, përderisa është vdekje nuk ekziston.

Ky është një zbërthim i ri, që mund të hapet vetëm me çelësin poetik.

Gjendje, do të thotë ekzistencë e çastit, për kryerje në provë të ekzistencës, në çdo fill trupi. Gjendje nënkupton një trup dhe një zemër të segmentarizuar, që kurrë nuk plotëson të tërën.

E tëra ekziston, dhe gjendja e kërkon, këtë plotëri, që nuk mund të arrihet.

Në moshën kur shfaqet për lexuesin, poezia e Elma Ramës, vargu bëhet i nderë, i tendosur edhe më fort, i lidhur pashmangshëm midis një çifti, që nga koha e Evës dhe Adamit.

Molla e mëkatit nuk ekziston më, në këtë boshësi që ka lidhje me mos pranime të tjera, përveç dashurisë.

Sa i ëmbël ky flirt qiellor,
e pangopur me mëkatin

“Midis epshit erotik dhe dashurisë së vërtetë”,
*thotë Elma Rama. Vetë trupi, s'është gjë tjetër veçse
një gotë jetë, që vetë poezia e mbush me njësi të
përditshme, ndoshta gjithnjë e më të pasofistikuara,
për ta lënë me lirinë që i ka dhënë vetë ardhja në këtë
jetë. Rëndësi ka të zbulosh dhe të vështrosh veten me
kurajë lirie të plotë.*

*Nuk mund të ishte kaq i lirë ky vështrim vetëm disa
vite më parë.*

Dhe tinëzare vjen sërish,
Gjendja amorfe.
Pikëtakimi Vdekja
Për drejt ajo e ndjen thirrjen
Dhe pa klithur
Dhe pa dhimbur
Dhe pa moshën
A ka arsye?
Gjithçka është arsye
Se vetë ajo nuk është!

***Çfarë ka ndodhur, vetëm nënkuptohet, ndodhet
përtej gjendjeve. Ndoshta jeton vetëm emocioni por
edhe ky i zbrazët, vetëm me vetveten. Vetëm valët e
detit nuk kanë për të munguar kurrë, për gruan që
jeton pranë tyre.***

E meriton së pari Vlora edhe poezinë e saj “Detaj”:

Gjithçka e qetë
Veç, dallgëve
Deti ka ardhur shumë pranë

Ndoshta, të na shpëlajë trutë
E rreckosur!
Furtuna e ditëve, ka ndalur
Të na kujtojë veten
Jetën, sa e bukur është.
Kështu e blatuar në ngjyra.
Po dehem pak, në fakt pak si shumë
Më mirë kështu, se esëll
Në rrëmujën turmë
Të vetëgatuar
Dhe vjen gjendja e vetë kohës.

Kjo peshë tokë-gjendje kohë

E lodhur nga moslodhja
Puthja kalon pa më prekur.

Metaforat e kësaj poezie kaq të veçantë vetjake mbushen me nënkuptime të eklipsit. Ato i dhurohen botës femërore së pari, por synimin e kanë te Molla e Adamit.

Pyetja e parë:

A mund të quhet poezia e Elma Ramës poezi erotike, apo hapësirë e mungesës së saj, filozofi dhe meditim i hapët, si bisedë që fillon me të gjithë?

Për këtë nuk përgjigjet vetëm autorja që ka marrë penën në duar, por vetë qenia femërore në vetvete.

Nuk është më aq konvencion, në detyrën e saj sociale, as shtyllë e zakonshme shtëpiake, as psherëtimë e largët.

Në pritje të vazhdueshme për plotërinë e saj, atje në brigjet vlonjate shumë pranë vajzës së valëve, gjendet një grua e lirë, në vetminë dhe vetësinë e saj, shumë pranë flamurit të karakteristikave shqiptare, e mbushur plot pritje, plot ëndrra dhe sigurisht me një gotë verë përpara, gjysmë e dehur nga dashuria dhe etja për jetë, që i jep një personalitet, i cili as mund të guxohet të kundërshtohet.

Dhe vetmi përshëndetëse, që plotëson edhe më mirë çerekun e parë të shekullit XXI, ku inteligjenca artificiale ka simotrat e saj. Në fund të fundit një grua shqiptare e fortë, por si një valë deti ku fryjnë të gjithë erërat, të pavarura apo të varura prej fateve të ndryshme njerëzore. E lirë. Dhe pikë.

Natasha Lako

ETYD MBRËMJEJE

Mbi tavolinë libri
Hapur nga shiriti i kuq
Aty ku dje e mbylli pavetëdija
Zgjuar nga avujt e pabesë.

Gota gjysmë e zhveshur
Është sërish aty.
E pangopur me mëkatin
Libri i hapur le të presë
Një tjetër mëkatar esëll!

QETËSI

Mbyll sytë dhe fle,
Në ëndërr askush nuk më largon nga ti
Askush nuk di, çfarë dua, për kë jetoj.
Në ëndërr jam veç unë e ti: përqaftuar
Dashuruar, prekur ëmbël
Siç ndodh
Veç në ëndërr!

E DEHUR JAM

E dehur jam?
Në fakt e dehur dua të jem
Të harroj, të rikrijoj, të ndjej pa frikë
Nëse jetë ka.

Le të jetë dhe brenda një gote,
Le të jetë dhe në përumbje
Le të jetë dreqi e mori dhe në çmenduri,
E dehur dua të vdes!

Vetëm kështu qenka e thënë:
Të ndihem lumtur, jetuar, gjallë!

REQUIEM PËR VARGJE TË DIKÛRSHME

Se ti
Më ringjalle një ëndërr, të vdekur.
Se ti
Më shërove një shpirt, të vrarë.
Ti,
Më vazhdove përgjysmën e një puthjeje
Diku harruar.
Veç ti
Më bëre, të qaj!

Dhe ti
Një çast më the: Stop!
Ëndrra vdiq
Më vdekur, se vdekja e parë.
Shpirti u trand
U thye, dërrmuar etja,
Gjysmëputhja e mbetur
Treti dhe eterin,
As loti nuk di më
të qajë!

ME ZJARRIN QË SHUHET

U shuan dhe thëngjijtë e fundit të zjarrit
Hiri, diku i zi, diku i bardhë, diku gri
Pezmin bart, si pendesë.
I butë hiri, në dukje fjetur
Tret i pangopur, gërma, frymë, falje
Tret mëkate, zgjime, harresa
Tret e tret fletët pa zë, pikat e gjakut mavi
Tret ikjet pa kthim
Si rrugicat qorre në muzg.
Ndoshta tret dhe mua dhe ty
Pranë tij fjetur.
Ky hi, i zi
Diku i bardhë e diku gri...

KJO BOTË E VOGËL

Para syve të mi, bota,
Kaq bjerrur e flashkët
Vende-vende, ca më keq...fossil
Ata që fijet e jetëve tona lëvizin
Të pashpirt.
Më jepni një arsye, të ndihem mirë!
E vogël bota, një grimcë
Në universin hapësirë.
Atëherë,
Pse kjo makutëri?
Më jepni një arsye, të fal gjakun e fëmijëve
Nën hi, a vdekur në uri.

Para syve të mi, bota!
S'mund të jetë vetëm e disave
Pak unë, pak ti, pak për të gjithë
Më jepni një arsye
Ti kërkoj arsyes time, vazhdimësinë!

PEMA IME

Tharë

Pema, që aq shumë e desha dikur.

Aty mbi breg, sërish,

Tash e pa jetë.

Gjethet e arta, si në vjeshtat shkuar

Nuk janë më

As ngjyrë, as prekje, as dhe një zë.

Vetmuar... dhe pse përreth

Të tjerë drurë, gëlojnë hareshëm

Vdekur... dhe pse përreth

Një det ngjyrash, thërret jetën.

Imazhi, do mbetet ëndrrave harruar.

I pemës së bukur, që aq shumë e desha

Dikur!

PEMË E RIGJETUR

Të kanë ofruar një stol...
Pemë e vetmuar.

E kush mund të vijë kaq larg, kaq lart
Nën degët e gjera dikur
Putheshin dhe yjet
Sot as ky stol i bukur
S' të ndihmon dot.

Pemë e braktisur,
Ndoshta diku për ty, rrjedh një pikë lot!

GUASKA

Mbylli kapakët e lodhur
Guaska aty, në fund të detit blu.
Nga alga, leshterikë e ndihur
Të humbasë
A ndoshta të zhduket!

Gjallesa të reja, kërkojnë shfaqje.
Guaskës aty në fund të detit
Tashmë i mjafton
Dhe vetëm errësira blu
Dhe... Heshtja!

SHËN VALENTIN

Më pak a më shumë?
S'di ku jemi ti dhe unë!